



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e KEK SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të KEK SH.A-së, të datës 24 qershor 2008, si dhe kërkesës së datës 22 korrik 2008, **në seancën e mbajtur më 15 gusht 2008 nxori këtë:**

VENDIM

I. I lejohet KEK Sh.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të:

- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova A
- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova B
- Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike dhe
- Licencës për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike, si në shtojcë të këtij vendimi.

1. Të gjitha dispozitat tjera të licencave të KEK Sh.A-së mbesin në fuqi.
2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi me datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar



Shtojcë: Nenet e deroguara të licencave të KEK SH.A-së

Licenca e Gjenerimit TC Kosova A			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset Gjeneruese	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 KEK SH.A duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007 të cilat raporte ende nuk i ka dorëzuar. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2.	Neni 14-Mjedisi	deri me 31 dhjetor 2010	KEK SH.A duhet të bëj përpjekje që sa më shpejtë që të jetë e mundur të marr nga MMPH Lejen e Përhershme për Mbrojtjen e Mjedisit. Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2009.
3.	Neni 15-Obligimi I Sigurimit	deri me 31 dhjetor 2010	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2009.
Licenca e Gjenerimit TC Kosova B			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset Gjeneruese	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 KEK SH.A duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007 të cilat raporte ende nuk i ka dorëzuar. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2.	Neni 12-Mjedisi	deri me 31 dhjetor 2010	KEK SH.A duhet të bëj përpjekje që sa më shpejtë që të jetë e mundur të marr nga MMPH Lejen e Përhershme për Mbrojtjen e Mjedisit. Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2009.
3.	Neni 15-Obligimi I Sigurimit	deri me 31 dhjetor 2010	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2009.
Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset e Operatorit të Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 KEK SH.A duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007 të cilat raporte ende nuk i ka dorëzuar. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2.	Neni 11-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-se ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
3.	Neni 12-Standardet e Sigurisë së Operimit	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
4.	Neni 13-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes së Bizneseve të Operatorit të Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
5.	Neni 18-Kodi i Sjelljes i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
7.	Neni 22-Obligimi i Sigurimit	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-se ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2009.



Licenca për Furnizim Publik me Energji Elektrike			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit Publik	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 KEK SH.A duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007 të cilat raporte ende nuk i ka dorëzuar. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2.	Neni 8-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
Licenca për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizim/Tregtisë me energji elektrike	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 KEK SH.A duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007 të cilat raporte ende nuk i ka dorëzuar. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2.	Neni 8-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.